



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 17/2022 regjistër (JR)  
Datë 28.03.2022

Nr. 30 i vendimit  
Datë 01.07.2024

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Relatore</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 01.07.2024, ditën e hënë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 17/2022 (JR), datë 28.03.2022, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Fahrije Gjana (Vata), prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, përfaqësuar nga av. Jordan Daci.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 504, datë 28.01.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Nenet A, B, C, Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 3, 4, 5, 7, 15, 17, 18, 28, 30, 31, 33, 42, 43, 116 dhe 122 të Kushtetutës; nenet 1, 6, 7, 13, neni 14 në lidhje me nenet 6, 7, 17 dhe 18 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, si dhe Protokollin nr. 12 i kësaj konvente; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit

nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 10, 12, 13, 14, 17, 30, 41 e në vijim, si dhe 66, 67, 77, 78, 80, 81 e në vijim të Kodit të Procedurës Administrative; nenet 1, 4, 7, 10, 11, 13, 14, 16, 18, 19, 20 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

### **Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

### **VËREN:**

#### **I. Rrethanat e çështjes dhe vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Fahrije Gjana (Vata), (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të drejtuesit/prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).
3. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: (a) ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; (b) ka kryer veprime fiktive me qëllim fshehje pasurie; (c) nga analiza financiare ka rezultuar se me të ardhurat e fituara nga punësimi i saj dhe personat e lidhur me të, nuk kanë pasur burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruara.
4. Mbështetur në sa më sipër, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe, bazuar në nenin 58, pika 1, shkronja “c”, si dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 504, datë 28.01.2022, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Fahrije Gjana (Vata), drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

## II. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit nr. 504, datë 28.01.2022, të Komisionit, ka ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), subjekti i rivlerësimit<sup>1</sup>, duke kërkuar:

i. *Konstatimin e shkeljeve të të drejtave Kushtetuese dhe ato të parashikuara nga KEDNj-ja, ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Fahrije Gjana (Vata), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.*

ii. *Riçeljen e hetimit gjyqësor në tri kriteret, zhvillimin e gjykimit në seancë gjyqësore publike dhe administrimin e provave të reja, për të cilat plotësohen kushtet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012.*

iii. *Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 504, datë 28.01.2022 dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Fahrije Gjana (Vata), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.*

## III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

### a) Juridiksioni i Kolegjit

6. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim që ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Fahrije Gjana (Vata), bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

### b) Legjitimimi i ankuesit

7. Subjekti i rivlerësimit/ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

### c) Forma e shqyrtimit të ankimit

8. Trupi gjykues shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen e juridiksionit të rivlerësimit që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Fahrije Gjana (Vata), ndaj vendimit nr. 504, datë 28.01.2022, të Komisionit, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 86/2014 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”).

---

<sup>1</sup> Bashkëlidhur ankimit ndodhet prokurë e posaçme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.03.2022, e noteres A. K. M., notere e Dhomës Kombëtare të Noterisë Tiranë, në të cilën e përfaqësuar Fahrije Gjana ka emëruar si përfaqësues të posaçëm të saj avokatin Jordan Daci, i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit si person fizik me emër “Daci and Associates, Attorneys at Law”, me NIPT {\*\*\*}, duke i dhënë kompetenca dhe të drejta të plota që të realizojë përfaqësimin dhe mbrojtjen e saj ligjore përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

9. Gjatë shqyrtimit të çështjes, nga verifikimi i akteve të përcjella nga Komisioni në Kolegj, konkretisht në dosjen e krijuar nga hetimi i kryer nga ILDKPKI-ja, trupi gjykues konstatoi se referuar të dhënave të certifikatës personale me nr. {\*\*\*}, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Kukës, datë 24.10.2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Fahrije Gjana (Vata), ka lindur më datë 16.03.1957, për rrjedhojë moshë e saj, në momentin e shqyrtimit të çështjes nr. 17/2022 (JR), është mbi 67 vjeç.
10. Në mbështetje të kësaj situatë faktike, si dhe bazuar në parashikimin e nenit 64 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 96/2016”)<sup>2</sup>, trupi gjykues çmoi se duhej vlerësuar paraprakisht plotësimi i kushteve ligjore për përfundimin e statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit, për shkak të mbushjes së moshën për daljen në pension pleqërie. Për këtë qëllim, trupi gjykues, bazuar në nenin 49, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016<sup>3</sup>, administroi në cilësinë e provës informacionin e përcjellë në formë shkresore në Kolegj nga KLP-ja dhe Gjykata Administrative e Apelit, si rezultat i kërkesave të drejtuara nga relatorja e çështjes, në mbështetje të nenit 14, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016<sup>4</sup>. Aktet e përcjella në Kolegj nga KLP-ja i janë bërë të njohura subjektit të rivlerësimit nga ky institucion. Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti parashtrime me shkrim mbi shkaqet e ngritura në ankim, sikurse parashikon neni 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012. Në këto kushte, trupi gjykues vendosi të vazhdojë gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi.
11. KLP-ja, si organi përgjegjës për verifikimin dhe deklarin e statusit të magjistratit, nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 20.05.2024, ka informuar Kolegjin se nga verifikimi i dosjes personale të znj. Fahrije Gjana (Vata) nuk rezulton që ajo të ketë paraqitur ndonjë kërkesë pranë këtij institucioni, për zgjatjen e qëndrimit në detyrë deri në moshën 70 vjeç. KLP-ja informoi se, për më tepër, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 28.03.2024, për “Mbarimin e statusit të magjistratit” është vendosur mbarimi i statusit të magjistratit për znj. Fahrije Gjana (Vata), duke përcjellë kopjen e njehsuar me origjinalin të vendimit të sipërcituar.
12. Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 28.03.2024, për “Mbarimin e statusit të magjistratit”, KLP-ja ka vendosur:
1. *Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit, më datë 12.04.2022, për znj. Fahrije Gjana (Vata), me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.*

---

<sup>2</sup> Neni 64, pika 5 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se: “[...] Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. Magjistrati, me kërkesën e tij, mund të qëndrojë në detyrë deri në moshën 70 vjeç. Kërkesa për qëndrimin në detyrë paraqitet jo më vonë se 6 muaj përpara plotësimin të moshës për pension. Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës [...]”.

<sup>3</sup> Neni 49, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Komisioni ose Kolegji i Apelit ka të drejtë: c) të marrë dokumente të tjera shkresore, sipas formave të parashikuara në ligj [...]”.

<sup>4</sup> Neni 14, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016, përcakton se: “5. Relatori i çështjes ka këto detyra: [...] ç) të kërkojë informacion shtesë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji; [...]”.

2. *Deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit jep efekt më datë 16.03.2024.*
  3. *Të njoftohet për këtë vendim znj. Fahrije Gjana (Vata), Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.*
  4. *Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.*
  5. *U shpall në Tiranë, sot, më datë 28.03.2024.*
13. Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.05.2024, KLP-ja ka informuar se *deri më datë 30.05.2024, sipas verifikimeve, rezulton se nuk është paraqitur asnjë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit*, ndaj vendimit nr. {\*\*\*}, datë 28.03.2024, për “Mbarimin e statusit të magjistratit” të znj. Fahrije Gjana (Vata), ndërsa me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 14.06.2024, KLP-ja ka informuar Kolegjin se vendimin nr. {\*\*\*}, datë 28.03.2024, ia ka dërguar për njoftim znj. Fahrije Gjana (Vata), më datë 02.04.2024.
  14. Gjykata Administrative e Apelit, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 28.05.2024, ka informuar Kolegjin se *nga verifikimet e kryera, deri më datë 27.05.2024, nuk rezulton të jetë regjistruar ankim nga znj. Fahrije Gjana (Vata) kundër vendimit nr. {\*\*\*}, datë 28.03.2024, të KLP-së.*
  15. Në analizë të fakteve të mësipërme dhe në konsideratë të parashikimit të nenit 192, pika 1 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sipas së cilit, ndaj aktit administrativ individual të KLP-së mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të aktit, trupi gjykues çmoi se vendimi nr. {\*\*\*}, datë 28.03.2024, i KLP-së, për “Mbarimin e statusit të magjistratit”, ka marrë formë të prerë.
  16. Rivlerësimi kalimtar i subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pika 3 e Kushtetutës kërkon si kusht logjik dhe juridik pasjen e statusit të magjistratit, për t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*.  
Trupi gjykues konstatoi se në momentin e regjistrimit në Kolegj të çështjes nr. 17 (JR), datë 28.03.2022, për shqyrtimin e ankimit<sup>5</sup> të subjektit të rivlerësimit Fahrije Gjana (Vata) kundër vendimit nr. 504, datë 28.01.2022, të Komisionit, znj. Fahrije Gjana (Vata) gëzonte statusin e magjistratit, status të cilin e ka humbur me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 28.03.2024, të KLP-së, për shkak të mbushjes së moshës për daljen në pension pleqërie, duke mos ushtruar më detyrën e prokurorit dhe, për rrjedhojë, nuk bën më pjesë në rrethin e subjekteve që duhet t’i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës<sup>6</sup> dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016<sup>7</sup>.
  17. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se objekti dhe qëllimi për të cilin kishte nisur procedura e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Fahrije Gjana (Vata) është bërë i pamundur dhe nuk mund të vazhdojë në Kolegj, për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit, si rezultat i parashikimit të nenit 64, pika 5 e ligjit nr. 96/2016.

<sup>5</sup> *Ankim i depozituar nga subjekti i rivlerësimit, më datë 11.03.2022.*

<sup>6</sup> *Neni 179/b, pika 3 e Kushtetutës përcakton se: “3. Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio”.*

<sup>7</sup> *Neni 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “3. “Subjekt i rivlerësimit” janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës”.*

18. Nisur nga fakti se subjektit të rivlerësimit i ka mbaruar statusi i magjistratit për një nga rastet e parashikuara nga ligji, në kushtet kur Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016 nuk kanë parashikuar ndonjë rregullim të posaçëm për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar në rastin e daljes në pension të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, bazuar në pikën 6, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi se mund të zbatojë parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe konkretisht nenit 95 të tij, të titulluar “Pamundësia në objekt apo qëllim”, i cili parashikon se: *“Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”*.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 64, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, me shumicë votash,

### **VENDOSI:**

Përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Fahrije Gjana (Vata), pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se objekti dhe qëllimi i këtij procesi është bërë i pamundur.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 01.07.2024.

#### **ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi - kundër*

#### **ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

#### **ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUESE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

## MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtarja Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues së çështjes (JR) nr. 17/2022, datë 28.03.2022, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Fahrije Gjana (Vata), kundër vendimit nr. 504, datë 28.01.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, kam votuar kundër vendimit (JR) nr. 30, datë 01.07.2024, të Kolegjit, që ka vendosur *përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Fahrije Gjana (Vata), pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se objekti dhe qëllimi i këtij procesi është bërë i pamundur, me arsyetimin si më poshtë.*
2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Fahrije Gjana (Vata), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio.*
3. Komisioni, pas konkluzioneve të arritura për kriterin e vlerësimit të pasurisë, se subjekti i rivlerësimit: *a) ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; b) ka kryer veprime fiktive me qëllim fshehje pasurie; c) nga analiza financiare ka rezultuar se me të ardhurat e fituara nga punësimi i saj dhe personat e lidhur me të, nuk kanë pasur burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruara, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 504, datë 28.01.2022, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Fahrije Gjana (Vata), drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.*
4. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar vendimin e Komisionit nëpërmjet ankimit, duke kërkuar, [...] *ii. Riçeljen e hetimit gjyqësor në tri kriteret, zhvillimin e gjykimit në seancë gjyqësore publike dhe administrimin e provave të reja, për të cilat plotësohen kushtet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. ii. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 504, datë 28.01.2022, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Fahrije Gjana (Vata), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.*
5. Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 28.03.2024, KLP-ja ka deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit, fakt mbi të cilën u bazua dhe vendimmarrja e mësipërme e shumicës së trupit gjykues.
6. Pavarësisht deklaramit të mbarimit të statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit, çka nënkupton edhe pamundësinë e znj. Gjana (Vata) për ushtrimin e detyrës në vijim, vlerësoj se procesi i rivlerësimit për këtë subjekt nuk e ka humbur aktualitetin dhe qëllimin e tij, pasi është si në interesin publik, ashtu edhe të vetë subjektit të rivlerësimit, për t'u njohur me konkluzionin përfundimtar të një kontrolli të ushtruar ndaj një funksionari publik që ka shërbyer mbi 20 vjet në sistemin e drejtësisë.
7. Duke pasur në vëmendje qëllimin e reformës në drejtësi, në vlerësimin tim është detyra e institucioneve të rivlerësimit dhe kryesisht Kolegjit, si e vetmja gjykatë e këtij procesi, që e

udhëhequr nga parimi i mbrojtjes së interesit publik dhe mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të subjektit të rivlerësimit, të shqyrtonte vendimin e Komisionit nëpërmjet analizimit të shkaqeve ankimore të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim, në mënyrë që të finalizonte këtë proces me një vendim përfundimtar duke i dhënë përgjigje subjektit të rivlerësimit, znj. Fahrije Gjana (Vata), për shkaqet e ngritura prej saj, në kushtet kur nuk paraqiti parashtrime me shkrim e aq më pak një kërkesë për mosshqyrtimin e ankimit. Ky është mendimi im për sa i përket zgjidhjes në themel të çështjes.

8. Përpos sa më sipër, për sa kohë procesi i rivlerësimit për subjektin në fjalë kishte nisur e konkluduar nga Komisioni me një vendimmarrje për shkarkim nga detyra të subjektit të rivlerësimit, dhe në një kohë që mjeti procedural (ankimi i subjektit), mbi bazën e të cilit është investuar Kolegji, mbeti efektiv, pa një tërheqje nga ana e subjektit, si dhe në një situatë të paqartësuar nga përgjigjja e KLP-së, mbi faktin nëse deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit, kishte nisur mbi bazën e kërkesës së magjistrates Fahrije Gjana (Vata) apo me iniciativën e vetë KLP-së, Kolegji ose duhet të kishte shqyrtuar këtë çështje dhe të dispononte në përputhje me parashikimet e nenit 66, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që përcakton se: *Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji i Apelimit vendos: (a) lënien në fuqi të vendimit të Komisionit; (b) ndryshimin e vendimit të Komisionit; (c) prishjen e vendimit të Komisionit, ose të vendoste për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit sipas përcaktimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Vendimmarrja e shumicës, bazuar në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Fahrije Gjana (Vata), pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se objekti dhe qëllimi i këtij procesi është bërë i pamundur, në vlerësimin tim nuk përfaqëson një zgjidhje të drejtë të çështjes, krahasuar me problematikat e analizuara nga Komisioni për kriterin e pasurisë, si dhe me konkluzionet e arritura prej tij që kanë çuar në shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.*
9. Për këto arsye, vendosa të mbaj qëndrim kundër në vendimmarrjen e shumicës së trupit gjykues, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Fahrije Gjana (Vata).

**GJYQTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*